

Hulumtim “Vendet e lira të punës”



Fëllënza Murtezi
Rrita Mustafa
Doruntina Berisha

Analiza e shpalljeve për vende të lira të punës, është një publikim i Kolegjit Universum, respektivisht Zyrës për Shërbime të Karrierës, publikim ky i cili ka për qëllim matjen e trendeve, dinamikës dhe strukturës së tregut të punësimit në Kosovë. Besohet se ky publikim do të ju mundësojë studentëve të Kolegjit Universum, dhe jo vetëm, të kenë informata lidhur me tregun e punës në Kosovë dhe të planifikojnë më mirë karrierën e tyre profesionale. Zyra e Karrierës do të kujdeset që në vazhdimësi të hulumtojë tregun e punës dhe të ofrojë informata të rëndësishme për studentët e Kolegjit. Të dhënat në këtë hulumtim janë mbledhur dhe analizuar nga studentet e Kolegjit Universum.

Përmbledhja ekzekutive

Hulumtim i vendeve të punës bazohet në një masë statistikore të përbërë nga hulumtimi i 4494 vendeve të shpallura të punës. Këto shpallje janë marrë nga burime të ndryshme si: gazetat ditore, portalet elektronike dhe web site të kompanive që kanë ofruar mundësi punësimi. Hulumtimi ka patur për bazë vetëm pozitat e ofruara gjatë vitit 2012. Analizimi i vendeve të shpallura është realizuar nga studentët e lartcekur të Kolegjit Universum, të cilëve u takon e drejta e autorit mbi të dhënat në këtë hulumtim.

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të ofrojë informata relevante rreth ofertës për punësim në Kosovë dhe në të njëjtën kohë të identifikojë aftësitë të cilat punëdhënësit kërkojnë tek kandidatët potencial. Besojmë se të dhënat e dala nga ky hulumtim do të shërbejnë në orientim të studentëve të Kolegjit dhe të punëkërkuësve në Kosovë.


Si i tillë, ky hulumtim ka identifikuar sektorët/pozitat më të kërkuara gjatë vitit 2012, aftësitë të cilat kërkohen nga punëdhënësi, dokumentet e nevojshme për aplikim, periudhën kur ka më shumë shpallje për vende të lira pune, njohja e cilave gjuhë kërkohet dhe informata tjera relevante që ndihmojnë në të kuptuar se kah po lëviz tregu i punës në Kosovë.

Konkretisht, ky hulumtim ofron matje të:

1. Pozitat që kërkohen në tregun e punës
2. Sa ka vende të lira puna në Komunitet e Kosovës
3. Sektori publik vs Sektori privat
4. Koha kur ka më së shumti vende të lira të punës
5. Kohëzgjatje e kontratës
6. Përgatitja profesionale – Arsimimi
7. Aftësitë e kërkuara
8. Njohuritë e gjuhëve të huaja
9. Përvoja e punës
10. Dokumentet për aplikim

Pozitat që kërkohen në tregun e punës

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur pozitat e lira të shpallura gjatë vitit 2012 për sektorë të ndryshëm në treg të punës. Ashtu siç mund të shihni, tri sektorët që më së shumti kanë patur vende të lira të punës janë: Siguri/Polici, Edukim/Trajnim si dhe Shitje. Sektori i Sigurisë/Policisë ka patur më së shumti vende të lira pune, respektivisht 991 pozita të lira. Në këtë sektor nuk hyjnë vetëm pozitat e lira në policinë e Kosovës, por edhe pozitat e lira të ofruara nga sigurimet private, dhe kjo përbën pjesën më të madhe të pozitave në këtë sektor.




Një pjesë tjetër prej 19%, përbëjnë pozitat e lira në sektorin e edukimit dhe trajnimit. Përderisa, pozitat e lira në shitje përbëjnë 13% apo 564 të pozitave të lira për vitin 2012. Pozitat e lira në Menaxhment përbëjnë 8% të mostrës dhe pozitat e lira në Administratë përbëjnë 6% të po të njëjtës mostrë.

Sa ka vende të lira të punës ne Komunat e Kosovës

Lehtë mund të imagjinohet se Prishtina, si kryeqytet i Kosovës ka më së shumti vende të lira të punës. Por, me këtë hulumtim kemi dashur të shohim se sa vende të lira të punës shpallen edhe në komunat tjera në Kosovë.


Prishtina gjatë vitit 2012 ka patur 49%, respektivisht 2208 vende të lira pune. Nga grafiku shihet qartë se shpërndarja e përqindjes me komunat tjera nuk tregon shumë. Tri komunat që afërsisht kanë shpërndarje të njëjtë janë: Podujeva, Mitrovica dhe Prizreni. Komunat me më së paku vende të lira të punës, respektivisht me nga tri vende të lira për gjatë tërë vitit 2012 janë Shtërpca, Parteshi, Graçanica dhe Mamusha. Duke mos patur publikime lidhur me fuqinë punëtore nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, ka qenë e pamundur të analizohen këto të dhëna më në detaje dhe të shikohet se çfarë relacioni ka në mes ofertës dhe kërkesës.



Sektori publik vs sektori privat


Përmes këtij hulumtimi kemi dashur të identifikojmë se cili sektor në Kosovë përbën punëdhënësin më të madh në Kosovë. Ky hulumtim na tregon se Qeveria e Kosovës nuk përbën punëdhënësin më të madh, sikurse shpesh aludohet. Mund të shihni se sektori privat përbën 61% të vendeve të lira të punës, ndërsa sektori publik përbën 37% të vendeve të lira të punës. Përqindja e vendeve të lira të punës nga sektori privat besohet të jetë më e madhe pasi shumica e aktorëve në sektorin privat nuk janë të obliguar të rekrutojnë nga konkurse publike.

Organizatave jo qeveritare ndërkombëtare gjatë tërë vitit kanë pasur 77 vende të lira të punës, ndërsa ato lokale kanë pasur vetëm 10 vende të lira të punës.




Koha kur më së shumti ka vende të lira pune

Nga hulumtimi shohim se dy muajt të cilët kanë më së shumti vende të lira pune, janë muaji Qershor dhe muaji Janar. Kjo ndodh për shkak të planifikimeve për fillim vit apo edhe planifikimeve për muajt e mesëm të vitit.




Kohëzgjatja e kontratave

Një brengë tjetër e përbashkët është edhe kohëzgjatja e kontratës së punës sepse konsiderohet se kontratat afatgjate tregojnë nivelin e sigurisë në punë. Përmes kësaj analize kemi dashur të masim edhe relacionin në mes të kontratave afatgjate, kontratave afatshkurtra – shërbimeve dhe punës praktike. Nga të grafiku i mëposhtëm shihet se 62% e vendeve të shpallura të punës, janë kontrata afatgjate. Ndërsa, 12% e kontratave janë për punë praktike, 6% janë kontrata shërbimi dhe 21% e vendeve të lira të punës, nuk specifikohet kohëzgjatja.




Përgatitja profesionale/ arsimimi

Cila është përgatitja profesionale që punëdhënësit e kërkojnë me vendet e lira të punës? Në grafikun e mëposhtëm, mund të shihet qartë se për 63% të vendeve të shpallura nevojitet vetëm shkolla e mesme, 53% niveli themelor i studimeve dhe niveli master vetëm për 20% të vendeve.




Aftësitë e kërkuara nga punëdhënësi

Ashtu siç mund të shihni në grafikun e mëposhtëm, punëdhënësit në Kosovë konsiderojnë se aftësia për të komunikuar është e domosdoshme për 87% të vendeve të shpallura të punës, aftësia për të punuar në grup në 67% të vendeve të shpallura dhe aftësi planifikuese dhe organizative në 52% të vendeve të shpallura. Përball kësaj, aftësitë të cilat zhvillohen nga procesi mësimor, aftësitë intelektuale, aftësi në të shkruar dhe mendim kritik si më pak të kërkuara në vendin e punës. Kjo na bën të mendojmë se punëdhënësit në Kosovë kanë qasje jo racionale përball punëkërkuësve, pasi që aftësitë të cilat ndërtohen gjatë shkollimit nuk paraqesin prioritet tek punëdhënësi.




Njohuritë e gjuhëve të huaja

Shic mund të shihni në rezultatet e mëposhtëm, 75% e konkurseve të analizuara të punës kërkojnë njohuri të gjuhës angleze. Gjuha angleze mbetet si gjuhë e cila më së shumti kërkohet nga punëdhënësit.




Përvoja e punës

Një elemente tjetër që kërkohet nga punëdhënësit është përvoja e punës. Në 77% të konkurseve të analizuara, si kriter për punësim është edhe përvoja e punës. Përvojë e punës konsiderohet të jenë eksperiencia dhe aftësitë të cilat personi i merr gjatë punës, shkollimit apo aktivitete tjera në shoqëri.



Dokumentacioni që kërkohet për aplikim



Cv-ja dhe dëshmitë mbi shkollimin mbeten si dokumentet më të kërkuara gjatë procesit të aplikimit. Kjo edhe njëherë na tregon se shkrimi të Cv-së duhet ti kushtohet shumë rëndësi.

Kolegji Universitar Universum është institucion i arsimit të lartë, i akredituar pa kusht nga Agjencia për Akreditim e Kosovës. Programet e studimit, menaxhimi institucional dhe sigurimi i cilësisë janë vlerësuar shumë lartë nga ekspertët ndërkombëtarë (shih raportet e akreditimit).

Universum ka partneritetet më të fuqishme ndërkombëtare nga të gjitha institucionet që veprojnë në Kosovë. Është i binjakëzuar me Chichester College (Angli), anëtarësuar në Global College Network, Anglia Network Europe, European Higher Education Society dhe ka mëse 30 institucione partnere nga e gjithë bota.

Është institucioni i vetëm privat në Kosovë i cili ka fituar grant nga Ambasada e SHBA-vë dhe Departamenti i Shtetit për zhvillimin e një Reviste Shkencore ndërkombëtare.

Universum është renditur ne Top 1000 Shkollat me të mira të biznesit ne Bote nga Eduniversal, si i vetmi institucion nga Kosova.

PRISHTINË

Ulpiana Kampus
Rr.Nik Prelaj, Objekti i "Beni Dones"
Tel. +381 38 555 315
Mob. + 377 44 144 062, 44 168 531
Skype: universum.college

Kampusi në Veternik

Veterniku pn, Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 38 544 210
+377 44 144 062
+377 44 168 531

FERIZAJ

Rr.Fan Noli, Nr.156
Tel. +381 290 324 596
Mob. + 377 44 354 034
Skype: universum-ferizaj

GJAKOVË

Rr.UÇK-së, përball pallatit të kulturës
Tel. +381 0390- 330990
Mob. + 377 44 209 347
Skype: universum-gjakova

PRIZREN

Rr.Azem Bejta, Nr.47
Prizren, Kosovë
Tel. +381 029 243 000
Mob. + 377 44 549 334, 44 996 614
Skype: universum-prizren